11.	Dragutin Nikolic	Kontinj er	Nuk posedon leje urbanistike	Dragutin Nikolic	-	
12.	Mirsad F.Kryeziu	Garazh ë pa nr.	Nuk posedon leje urbanistike	Mirsad F.Kryeziu	-	
13.	Ismet Qehaja	Garazh ë nr. 82	Nr.127/07 dt.04.06.2007	Ismet Qehaja	100	
14.	Skender Sh.Bunjaku	Kontinj er	Nuk posedon leje urbanistike	Skender Sh.Bunjaku	-	
15.	Musa Qehaja	Garazh ë nr. 84	Nr.124/07 dt.04.06.2007	Ismet Qehaja	100	
16.	Dragutin Nikolic	Garazh ë	Nuk posedon leje urbanistike	Dragutin Nikolic	-	
17.	Ramush Agaj	Garazh ë	Nuk posedon leje urbanistike	Ramush Agaj	-	
18.	Novica(Dragutin) Denic	Garazh ë	Nuk posedon leje urbanistike	Novica(Dragutin) Denic	-	

LISTA E SHFRYTËZUESËVE TË HAPËSIRËS PUBLIKE TË EVIDENTUAR DHE TË PAISURA ME LEJE URBANISTIKE - PA LEJE URBANISTIKE - PËR KIOSQE , BARAKA MONTAZHË NË LOKACIONIN PERBALLË ISH KOMUNËS SË KAMENICËS

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Lloji i objektit	Leje urbanistike	Lloji i veprimtarisë	Shfrytëzuesi aktual	Borxhi- € (deri v.2015)	Vërejtje
1.	Bajram Krivaqa	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Mobishop	Afrim Krivaqa	0	
2.	Ruzhdi Morina	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Shitja e gjerave te ndryshme	Ruzhdi Morina	0	
3.	Riza Qehaja	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Frizer për meshkuj	Riza Qehaja	0	
4.	Xhelal Morina	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Librari	Xhelal Morina	0	
5.	Sabri Demolli	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Tv Servis	Rufadije Hyseni	0	
6.	Ahmet Hoti	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Këpuqtar	Ahmet Hoti	0	
7.	Hevzi Ismajli	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Qebapetore	Hevzi Ismajli	0	

8.	Xheladin Kryeziu	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Frizer për meshkuj	Xheladin Kryeziu	600	
9.	Hajrullah Keqmezi	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Shitja e gjerave te ndryshme	Ne rregull	0	
10.	Nijazi Hyseni	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Hamburger	Rufadije Hyseni	0	

Vërejtje-Barakat e vendosura përballë Gjymnazit "Ismail Qemali", në Kamenicë kanë qene te pajisura me Leje Urbanistike, mirepo me rastin e dislokimit ne tjeter lokacon te njejtat nuk posedoj Leje Urbanistike.

**LISTA E SHFRYTËZUESËVE TË HAPËSIRËS PUBLIKE TË EVIDENTUAR DHE TË PAISURA ME
LEJE URBANISTIKE - PA LEJE URBANISTIKE, PËR KIOSQE , BARAKA MONTAZHË NË
LOKACIONIN AFER POMPËS SË BENZINES, RRUGA "SKENDERBEU" PREJ URËS – DERI TE
TREGU I GJELBËRT, TOPANICË DHE HOGOSHT**

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Lloji i objekti	Leje urbanistike	Lloji i veprimtarisë	Shfrytëzuesi aktual	Borxhi-€ (deri v.2015) €	Vërejtje
1.	Idriz Dërmaku	Kioskë/ Barakë	Nr.061-04/ 07, dt .14.05.2007	Frizer për meshkuj	Gazmir Kastrati	0	
2.	Sadri Kastrati	Kioskë/ Barakë	Nr.196 -04/ 07 dt .19.09.2007	Qebapetore	Aziz Ajvazi	0	
3.	Xhelal Hoda	Kioskë/ Barakë	Nr.035/01,dt.01.03.2002	Mobi Shop	Xhelal Hoda	48.00	
4.	Krsta Trajkovic- (Zjadin Spahiu, Faton Kastrati)	Kioskë/ Barakë	Nr.03-353-2, dt.16.05.1986	Avokaturë	Enver Ajvazi	950.00	
5.	Femi Shkodra	Kioskë/ Barakë	Date .06.04. 2000	Rrobaqepës	Femi Shkodra	846.00	
6.	Refik Basha	Kioskë/ Barakë	Nr.228/07, dt.26.10.2007	Avokaturë	Refik Basha	0.40	
7.	Memin Sylaj	Kioskë/ Barakë	Nr.09/234, dt.27.09.2013	Avokaturë	Lulzim Canaj	-	
8.	Sali Lipovica	Kioskë/ Barakë	nuk posedon leje urbanistike	Frizer për meshkuj	Kujtim M. Bunjaku	268.80	
9.	Emine Krasniqi	Kioskë/ Barakë	Nr.075/02, dt.17.04.2002	Frizere per femra / Këpuçetar	Lavdim (Fazli) Lecaj	1,294.00	
10.	Ismet Ramabaja	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Avokaturë	Granit B.Mavriqi	2,050.80	
11.	Skender Fetiu	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Shitja e gjerave te imta	Skender Fetiu	768.00	
12.	Srecko Nikolic (Skender Fetiu)	Kioskë/ Barakë	Nr.256/02, dt.30.10.2002	Rrobaqepes	Skender Fetiu	1,460.60	
13.	Skender Fetiu	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Rrobaqepes	Skender Fetiu	576.00	
14.	Rrustem Sadiku	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Mobishop	Rrustem Sadiku	1,853.60	
15.	Mileta Djordjevic (Ramiz Sadiku)	Kioskë/ Barakë	Nr.03-353-4/92, dt.05.11.1992	Kompjureta	Ramiz Sadiku	2,005.40	
16.	Hasan Sadiku	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike		Hasan Sadiku	1,608.40	

17.	Ramush Agaj	Kioskë/ Barakë	Nr.040/01, dt.05.03.2002	Shitja e gjerave te imta	Pasive	1,487.20	Ndërtim me material të forte (pa leje)
18.	Muhamet Mujaj	Kioskë/ Barakë	06 nr. 168 / 2010 dt. 25.10. 2010	Berber	pasive	120.00 €	
19.	Sami Shala	Kioskë/ Barakë	Nr. 205 date 04.09.32003	Shitja e gjerave te imta	Pasive	0.20 €	

**LISTA E SHFRYTËZUESËVE TË HAPËSIRËS PUBLIKE TË EVIDENTUAR DHE TË PAISURA ME LEJE
URBANISTIKE - PA LEJE URBANISTIKE, PËR KIOSQE , BARAKA MONTAZHË NË LOKACIONIN
AFER QERDHËS SË FËMIJËVE “ FILIZAT “**

Nr	Emri dhe Mbiemri	Lloji i objekti t	Leje urbanistike	Lloji i veprimtarisë	Shfrytëzuesi aktual	Borxhi-€ (deri v.2015)	Vërejtje
1.	Sejdi Berisha	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Servis i teknikes se bardhe	Sejdi Berisha	3,052.00	
2.	Lulzim Thaqi	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Internet	Burim Qehaja	135.00 €	
3.	Abedin Kryeziu	Kioskë/ Barakë	Nr.048-04/ 2007 datë .6.05.2008	Gjelltoore	Venera Hyseni	3,542.16	
4.	Bukurije Thaqi	Kioskë/ Barakë	Nr.086/01, dt.26.04.2002	Sallon ondulimi	Jeton (Rexhep) Bajra	2,040.00	
5.	Halide Sadiku	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike		Pasive	2,597.64	
6.	Resmije Thaqi	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Frizer per meshkuj	Nehat Bugaqku		
7.	Refik Sadiku	Kioskë/ Barakë	Nr.03-353-25/89 datë 14.12.1989	Zyre per perkthime	Bekim Arifi	1,744.00	
8.	Fetije Hasani	Kioskë/ Barakë	Nr.097/03 datë .12.05.2003	Frizere per femra	Valbona Ramadani	0	

**LISTA E SHFRYTËZUESËVE TË HAPËSIRËS PUBLIKE TË EVIDENTUAR DHE TË PAISURA ME LEJE
URBANISTIKE - PA LEJE URBANISTIKE, PËR KIOSQE , BARAKA MONTAZHË NË LOKACIONIN
AFER HOTELIT “MINERAL”**

Nr	Emri dhe Mbiemri	Lloji i objekti t	Leje urbanistike	Lloji i veprimtarisë	Shfrytëzuesi aktual	Borxhi-€ (deri v.2015)	Vërejtje
1	Shoqata e Gjuetareve “Thellnza”	Bodru m + Kioskë/ Barakë	Nr.237/02 datë .11.10.2002	Zyre shoqates	Pasive	5,272.64	
2	Fikrije Mavriqi	Kioskë/ Barakë	Nr.254/02 datë .28.10.2002	Frizere per femra	Pasive	2,466.00	
3	Shoqata e Bletareve “Luzma”	Kioskë/ Barakë	Nr.178/02 datë 21.08.2002	Zyre te shoqates	Pasive	2,684.40	

4	Xhevdet Krasniqi	Kioskë/ Barakë	Nuk posedon leje urbanistike	Frizere per femra	Pasive	5.493.60	
5	Tevide Hoti	Kioskë/ Barakë	Nr.069-0/2009 dt. 21.05.09	Frizere per femra	Pasive	1,422.00	

Në bazë të asaj që u theksua, u raportua si më lartë.

Komisoni :

1. Driton Sylaj, kryetar i komisonit
2. Sami Morina, anëtar
3. Arif Skoverqani, anëtar





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë

Më:14.03.2025

Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, në nenin 38) të Statutit të Komunës së Kamenicës Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023, Draft-Planit Sh.01, Nr.40603 i datës: 11.12.2023, Kuvendi i Komunës së Kamenicës, në seancën e mbajtur me 28.02.2025, miraton këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË KAMENICËS PËR VITIN 2025

1. Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Kamenicës miraton Planin e Punës të Kuvendit të Komunës së Kamenicës për vitin 2025.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani Sh.01, Nr.4112 i datës: 21.02.2025 i Punës së Kuvendit të Komunës së Kamenicës për vitin 2025.
3. Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqe të komunës.
4. Përkujdesjen për zbatimin e Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2025, e bënë Kryesuesi i Kuvendit Komunal.

Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Kryesuesit të Kuvendit,
- MAPL-së,
- Shërbimit të Kuvendit
- Zyrës së Përkthimit
- QShQ-Arkivit



Liridon Kastrati

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
 QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
 CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
 Sh. U. 01 Nr. 4112
 Nr. I faq. 02 Data: 21/02/2025
 KAMENICEJA

Draft-Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Kamenicës për vitin 2025

	Rendi i ditës - Vendimet/Çështjet
JANAR 2025	- Raporti financiar Tetor-Dhjetor për vitin 2024. - Raporti i punës së Kryetarit për gjashtë mujorin e dytë të vitit 2024 - Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025
SHKURT 2025	- Propozim vendim për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual. - Plani i punës së KKSBB-së për vitin 2025.
MARS 2025	- Informatë mbi kriteret dhe indikatorët e performancës - Bartja e mjeteve financiare të pashpenzuara nga viti 2023-2024 në vitin 2025 - Plani i punës së Prokurimit për vitin 2025 - Raporti vjetor financiar Janar-Dhjetor 2024
PRILL 2025	- Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2025. - Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit . - Hartimi i rregulloreve të ndryshme komunale. - Shqyrtimi i rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.
MAJ 2025	- Rishikimi i buxhetit të komunës për vitin 2025. - Informatë mbi qarkoren e parë buxhetore të MF-së.. - Pytjet e legjislativit drejtuar ekzekutivit
QERSHOR 2025	- Korniza afatmesme buxhetore 2026-2027. - Raporti i Prokurimit për vitin 2025 - Informatë mbi zbatimin e Planit të Prokurimit për vitin 2025. - Informatë rreth (6) mujorit të raportit të punës së “NPL” Dardana.

KORRIK 2025	• Raporti i dytë financiar për periudhën Prill – Qershor 2025. • Raporti i gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës mbi gjendjen ekonomike financiare të Komunës së Kamenicës. • Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025. • Raporti për vlerësimin e performances së Komunës për vitin 2024.
GUSHT 2025	• Informatë mbi suksesin e arritur të nxënësve në fund të gjysëmvetorit të dytë të vitit shkollor 2025-2026. • Informatë mbi Qarkoren e dytë të brendshme Komunale • Shqyrtimi i rregulloreve të ndryshme Komunale • Informatë për korrje-shirjet.
SHTATOR 2025	• Miratimi buxhetit të komunës për vitin 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitin 2026-2027. • Informatë mbi përfundimin e vitit të ri shkollor 2024/2025.
TETOR 2025	• Raporti financiar për periudhën Korrik – Shtator 2025. • Raporti periodik lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve të auditorit . • Hartimi, miratimi i rregulloreve të reja komunale
NËNTOR 2025	• Informatë mbi mbjelljet vjeshtore nga drejtoria e bujqësisë. • Informatë mbi gjendjen në shëndetësi. • Pytjet e legjislativit drejtuar ekzekutivit
DHJETOR 2025	• Raporti mbi Planin e Prokurimit të Komunës për vitin 2025. • Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2025. • Informatë për zbatimin e Planit vjetor të prokurimit. • Informatë mbi planin vjetor të Auditorit të Brendshëm , • Informatë për raportin e punës së “NPL” Dardana për vitin 2025

Liridon KASTRATI
Kryesues i Kuvendit të Kamenicës





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË Q
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANIN

Sh. 01 Nr. 7081
U. Br.
Nr. i faq. 1 Data: 25/03
Br. str. Datum:
KAMENICËJA 2025

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 14.03.2025

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit Nr.03/L-040 për vetqeverisjen Lokale, nenit 9 paragrafi 1.7 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/12 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi si dhe Planit Sh.02. Nr.3798 i dt. 18.02.2025 të Punës së KKSB-së për vitin 2024, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë:28.02.2025 mori këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** Plani i Punës së Komisionit Komunal për Siguri në Bashkësi Sh.02. Nr.3798 i dt. 18.02.2025, për vitin 2025.
2. Pjesë e këtij vendimi është Plani Komunal për Siguri në Bashkësi, Sh.02. Nr.3798 i dt. 18.02.2025, për vitin 2025.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal,

Vendimi ti dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit,
- Shërbimit të Kuvendit
- Zyrës së Përkthimeve
- MAPL-së
- QSHQ-arkiv

Liridon Kasirani

Kryesues i Kuvendit të Kamenicës





Republika e Kosovës
Republika Kosovë
Republic of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PER SHERBIM TE QY
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Nr. 02 Nr. 3798
Br. 4
Data: 18/02
Datum: 2025
KAMENICE/A

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Republika e Kosovës
Komuna e Kamenicës

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Datë: /2025

Nr.01

Draft: Plani i punës së KKS-së për vitin 2025

K a m e n i c ë

SHKURT, 2025

Qëllimi i planit është përmisimi i sigurisë publike dhe ndërtimi komunitetit më të sigurt si rritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve të qytetareve dhe palëve të interesuara për sigurinë në komunitet.

Nr.	Objektiva	Aktiviteti	Afati	Bartës i Aktivitetit
1.	Rritja e vetëdisimit të qytetareve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal	-Programe edukative neper shkolla; -Angazhimi i autoriteteve dhe institucioneve lokale.	Mars - Dhjetor 2025	KKSB/Drejtoritë Komunale /Policia
2.	Identifikimi i brengave lidhur me sigurinë Publike	-Organizimi i takimeve të rregullta; -Bashkëpunim me akter të tjerë për sigurinë si institucionet arsimore, organizatat rinore, OJQ-të dhe ato fetare.	Mars - Dhjetor 2025	KKSB/Drejtoritë Komunale /Policia
3.	Rekomandimi i planeve të veprimit dhe adresimi i brengave të qytetareve të autoriteteve komunale	-Mbledhjet e KKSBB-së; -Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve; -Mbledhje të Kuvendit Komunal .	Mars - Dhjetor 2025	KKSB/Drejtoritë Komunale /Policia
4.	Ndërtimi i besimit në mes të policisë dhe qytetareve nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi	-Takime të rregullta të komuniteteve; -Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje ; -Përdorimi i teknologjisë për të ndërtuar besimin.	Mars - Dhjetor 2025	KKSB/Drejtoritë Komunale /Policia
5.	Përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimit të gjithë qytetarëve për qeshjet e krimit dhe qeshjet tjera të cilat lidhen me kualitetin e jetës	-Promovimi i përfaqësimit të barabartë të qytetarëve ; -Përfshirja e qytetareve në zgjidhjen e problemeve.	Mars- Dhjetor 2025	KKSB/Drejtoritë Komunale /Policia

Kryetari i Komunës

KADRI RAHIMAJ





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Republika e Kosovës
Komuna e Kamenicës

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Datë: /2025

Nr.01

Draft: Plani i punës së KKSB-së për vitin 2025

K a m e n i c ë
SHKURT, 2025

Qëllimi i planit është përmisimi i sigurisë publike dhe ndërtimi komunitetit më të sigurt si rritja e bashkëpunimit në mes të institucioneve të qytetareve dhe palëve të interesuara për sigurinë në komunitet.

Nr.	Objektiva	Aktiviteti	Afati	Bartës i Aktivitetit
1.	Rritja e vetëdisimit të qytetareve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal	-Programe edukative neper shkolla; -Angazhimi i autoriteteve dhe institucioneve lokale.	Mars - Dhjetor 2025	KKSB/Drejtoritë Komunale /Policia
2.	Identifikimi i brengave lidhur me sigurinë Publike	-Organizimi i takimeve të rregullta; -Bashkëpunim me akter të tjerë për sigurinë si institucionet arsimore, organizatat rinore, OJQ-të dhe ato fetare.	Mars - Dhjetor 2025	KKSB/Drejtoritë Komunale /Policia
3.	Rekomandimi i planeve të veprimit dhe adresimi i brengave të qytetareve të autoriteteve komunale	-Mbledhjet e KKSB-së; -Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve; -Mbledhjet e Kuvendit Komunal .	Mars - Dhjetor 2025	KKSB/Drejtoritë Komunale /Policia
4.	Ndërtimi i besimit në mes të policisë dhe qytetareve nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi	-Takime të rregullta të komuniteteve; -Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje ; -Përdorimi i teknologjisë për të ndërtuar besimin.	Mars - Dhjetor 2025	KKSB/Drejtoritë Komunale /Policia
5.	Përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimit të gjithë qytetarëve për qeshjet e krimit dhe qeshjet tjera të cilat lidhen me kualitetin e jetës	-Promovimi i përfaqësimit të barabartë të qytetarëve ; -Përfshirja e qytetareve në zgjidhjen e problemeve.	Mars- Dhjetor 2025	KKSB/Drejtoritë Komunale /Policia

Kryetari i Komunës

KADRI RAHIMAJ





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

Republika Kosova
Opština Kamenica

Opštinski Savet za Bezbednost u Zajednici

Datum: /2025

Br.01

Nacrt: Plan rada OSBZ-e za 2025 godinu

K a m e n i c a

FEBRUAR, 2025

Svrha plana je poboljšanje javne bezbednosti i izgradnja sigurnije zajednice, kao povećanje saradnje između institucija, građana i strana zainteresovanih za bezbednost u zajednici.

Br.	Cilj	Aktivnosti	Rok	Nosilac aktivnosti
1.	Podizanje svesti građana u vezi sa prirodom zločina, neregularnosti i nasilna ponašanja u lokalnoj zajednici	-Obrazovni programi po školama; -Angažovanje lokalnih organa i institucija.	Mart – Decembar 2025	OSBZ/Opštinska Odeljenja /Policija
2.	Identifikacija zabrinutosti u vezi Javne bezbednosti	-Organizovanje redovnih sastanaka; -Saradnja sa drugim akterima za bezbednost kao obrazovne ustanove, omladinske organizacije, NVO-e i verske zajednice.	Mart – Decembar 2025	OSBZ/Opštinska Odeljenja /Policija
3.	Preporuka akcionih planova i adresa zabrinutosti građana kod opštinskih organa	-Sastanci OSBZ; -Sastanci Upravnog odbora; -Sednice Skupštine Opštine.	Mart – Decembar 2025	OSBZ/Opštinska Odeljenja /Policija
4.	Izgradnja poverenja između policije i građana kroz izgradnju partnerstva i zajedničkih inicijativa za rešavanje problema bezbednosti u svakoj zajednici	-Redovni sastanci zajednica; -Uključivanje građana u donošenje odluka; -Korišćenje tehnologije za izgradnju poverenja.	Mart – Decembar 2025	OSBZ/Opštinska Odeljenja /Policija
5.	Predstavljanje gledišta i briga svih građana za pitanja o zločinu i druga pitanja vezana sa kvalitetom života	-Unapređenje ravnopravne zastupljenosti građana. -Uključivanje građana u rešavanju problema.	Mart – Decembar 2025	OSBZ/Opštinska Odeljenja /Policija

Predsednik Opštine

KADRI RAHIMAJ





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Republika Kosova
Opština Kamenica

Opštinski Savet za Bezbednost u Zajednici

Datum: /2025

Br.01

Nacrt: Plan rada OSBZ-e za 2025 godinu

K a m e n i c a

FEBRUAR, 2025

Svrha plana je poboljšanje javne bezbednosti i izgradnja sigurnije zajednice, kao povećanje saradnje između institucija, građana i strana zainteresovanih za bezbednost u zajednici.

Br.	Cilj	Aktivnosti	Rok	Nosilac aktivnosti
1.	Podizanje svesti građana u vezi sa prirodom zločina, neregularnosti i nasilna ponašanja u lokalnoj zajednici	-Obrazovni programi po školama; -Angažovanje lokalnih organa i institucija.	Mart – Decembar 2025	OSBZ/Opštinska Odeljenja /Policija
2.	Identifikacija zabrinutosti u vezi Javne bezbednosti	-Organizovanje redovnih sastanaka; -Saradnja sa drugim akterima za bezbednost kao obrazovne ustanove, omladinske organizacije, NVO-e i verske zajednice.	Mart – Decembar 2025	OSBZ/Opštinska Odeljenja /Policija
3.	Preporuka akcionih planova i adresa zabrinutosti građana kod opštinskih organa	-Sastanci OSBZ; -Sastanci Upravnog odbora; -Sednice Skupštine Opštine.	Mart – Decembar 2025	OSBZ/Opštinska Odeljenja /Policija
4.	Izgradnja poverenja između policije i građana kroz izgradnju partnerstva i zajedničkih inicijativa za rešavanje problema bezbednosti u svakoj zajednici	-Redovni sastanci zajednica; -Uključivanje građana u donošenju odluka; -Korišćenje tehnologije za izgradnju poverenja.	Mart – Decembar 2025	OSBZ/Opštinska Odeljenja /Policija
5.	Predstavljanje gledišta i briga svih građana za pitanja o zločinu i druga pitanja vezana sa kvalitetom života	-Unapređenje ravnopravne zastupljenosti građana. -Uključivanje građana u rešavanju problema.	Mart – Decembar 2025	OSBZ/Opštinska Odeljenja /Policija

Predsednik Opštine

KADRI RAHIMAJ





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 14.03.2025

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2 shkronja d), neni 17, shkronja o), neni 40, paragrafi 40.2, shkronja i) të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008"), të nenit 24 të Ligjit nr. 04/L 071, për sistemin e adresave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 29/27, dhjetor 2011) i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Udhëzimit administrativ, nr. 17/2019, për krijimin e listës alfabetike për emërtime të listës rezervë dhe vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave, dhe të nenit 5 paragrafi 5.1 shkronja o), neni 38 paragrafi 38.2 shkronja l)) të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë:28.02.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Vendimi për caktimin Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Kamenicës, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Kamenicës.
2. Anëtarë të Komisionit, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, janë:
 - 2.1. Sylejman Kallaba (DUPH), Kryesues,
 - 2.2. Edon Dërmaku (DZHED), anëtar,
 - 2.3. Ramush Ismajli (DPKGJ), anëtar,
 - 2.4. Edon Canaj (DBF), anëtar, dhe
 - 2.5. Besim Morina (DSHPAIE), anëtar.
3. Detyrë e Komisionit është bashkëpunimi me drejtoritë komunale, ku duhet të veprojnë në harmoni me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-071, për sistemin e adresave dhe rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Kamenicës, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Kamenicës.

4. Pas përfundimit të punës së këtij komisioni, listat me emërtimet e propozuara të paraqiten në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

***Vendimi t'i dërgohet:** Mapl-së, Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës për Përkthime, Anëtarëve të Komisionit, dhe QSHQ- arkivi.*


Liridon Kastrati
Kryesues i Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOS
QENDRA PËR SHËRBIM TË
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë

Më: 14.03.2025

Sh. 01 Nr. 7083
U. Br.
Nr. i faq. 2 Data: 25/03
str. str. Datum:
KAMENICË 2025

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronjat e) dhe f) të Ligjit Nr.03/L- 040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, neni 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendimit Komunal Sh.02.Nr.32660 i datës 10.10.2024 për miratimin e Buxhetit Komunal për vitin 2025 dhe parashikimin për vitet 2026 - 2027, si dhe Vendimit Nr.07/165 datë 12.10.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Kërkesa Sh.02.Nr.3637 e datës 14.02.2025 e parashtruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A z. Gazmend Mavriqi, nenit 38 të Statutit Sh.02.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2025 miraton këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE - "DARDANA" Sh.A

1. Me këtë vendim i ndahen mjete financiare në shumë 71.000 Euro (Shtatëdhjetë e një mijë euro) për subvencionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A.
2. Shuma e mjeteve financiare sipas këtij vendimi ndahet nga buxheti i Komunës së Kamenicës, kategoria e Subvencioneve, Kodi buxhetor 16029 e Zyrës së Kryetarit, dhe ka për qëllim dhënien e ndihmës financiare për funksionimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A.
3. Shuma e mjeteve financiare sipas këtij vendimi bartet nga Komuna në xhirollogarinë bankare të Ndërmarrjes Publike Lokale - "Dardana" Sh.A.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.
5. Këtij Vendimi i bashkangjitet Kërkesa Sh.02.Nr.3637 e datës 14.02.2025 e parashtruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A z. Gazmend Mavriqi.
6. Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren Nr.06/2021.

Arsyetim

Ky vendim është marrë me qëllim të sigurimit të mjeteve financiare për blerjen e makinerive punuese dhe pajisjeve të nevojshme për punë për Ndërmarrjen Publike Lokale "Dardana" Sh.A.

Ndërmarrja Publike Lokale "Dardana" Sh.A luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët e Komunës së Kamenicës. Për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve, është e nevojshme që ndërmarrja të pajiset me makineri punuese dhe pajisje të domosdoshme për kryerjen e detyrave operationale.

Ndarja e këtyre mjeteve financiare bazohet në kërkesën Sh.02.Nr.3637 e datës 14.02.2025 e parashtruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A z. Gazmend Mavriqi, duke marrë parasysh rëndësinë e përmirësimit të kapaciteteve teknike dhe operationale të saj. Ky investim synon të lehtësojë funksionimin e ndërmarrjes dhe të sigurojë një mbarëvajtje më të mirë të aktiviteteve të saj.

Bazuar në këto arsye, është vlerësuar e domosdoshme ndarja e mjeteve financiare për të mbështetur Ndërmarrjen Publike Lokale "Dardana" Sh.A.

***Vendimi t'i dërgohet:** Mapl-së, Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe QSHQ- arkiv..*

Liridon Kastrati
Kryesues i Kuvendit të Kamenicës





**NDËRMARRJA
PUBLIKE
DARDANA**

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE DARDANA

Sh. 02 Nr. 22

Nr. 2 Data 14.05.2025

Kamenicë

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE “DARDANA” SH.A. KAMENICË

REFERENC-Ë:	Nr.02/22
PËR/ZA/TO:	z. Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës z. Liridon Kastrati, Kryesues i Kuvendit
CC:	Komisioni Komunal i Aksionarëve
NGA/OD.FROM:	Gazmend Mavriqi, Kryeshef Ekzekutiv
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për donacion
Lokacioni	Kamenicë
Data:	14.02.2025

I nderuar Kryetar,

Ndërmarrja Publike Lokale “Dardana”SH.A., Kamenicë, në përputhje me nevojat e vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ofron, kërkon mbështetje për realizimin e investimeve kapitale në mjete pune.

Këto investime janë të domosdoshme për të mundur:

Rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve të NPL “Dardana”SH.A.;

Përmirësimin e kushteve të punës për punonjësit e NPL-së dhe përmirësimin e sigurisë në punë;

Përmbushjen e standardeve të cilësisë për ofrimin e shërbimeve, si dhe përmirësimin e impaktit mjedisor.

Në këtë kuadër, kërkojmë që Kuvendi Komunal të marrë parasysh kërkesën tonë dhe të bëjë të mundur ndarjen e fondeve të nevojshme për investime kapitale në mjetet e punës, të cilat

janë të përshkruara edhe në Planin e Biznesit në faqen 20, ku si provë do të dërgojmë edhe Planin e Biznesit, të cilat përfshijnë:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1.	Kompjuter dhe paisje për zyre, programe	2 000.00€
2.	Thithëse me brusha (e përdorur), për pastrimin e qytetit	20.000.00€
3.	Kamionë me koshë ngritës	25.000.00€
4.	Cisternë për ujitje të hapësirave të gjelbërta publike dhe larjen e rrugëve	3 000.00€
5.	Pirunëngrites	5.000.00€
6.	Veturë e përdorur për administratë	9 000.00€
7.	Veturë mallërash (Pikap, kombi) e përdorur	7 000.00€

Ky investim është thelbësor për të përmirësuar shërbimin që ofrohet ndaj qytetarëve të Komunës së Kamenicës, për të siguruar funksionimin e pa ndërprerë të aktiviteteve tona.

Për këtë arsye, kërkojmë që ky propozim të shqyrtohet dhe të merret në konsideratë nga Komuna për alokimin e fondeve të nevojshme për realizimin e këtyre investimeve kapitale.

Jemi të gatshëm për të ofruar çdo informacion shtesë që mund të kërkohet dhe të bashkëpunojmë për realizimin e këtij projekti të rëndësishëm.


Faleminderit për mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj.

Me respekt !



PLANI I BIZNESIT PËR VITIN 2025

Miratohet Plani i Biznesit i NPL DARDANA Sh.a për
Vitin 2025

	Propozoj	Aprovoj
Pozita	Kryeshef Ekzekutiv	Kryesusja e Bordit të Drejtorëve
Emri & Mbiemri	Gazmend B. Mavriqi	Donjetë Morina
Nënshkrimi		
Data:	Vula	
14.02.2025		

PËRMBAJTJA

Përmbledhje –Hyrje	3
Misioni	4
Vizioni	4
Plani i Marketingut.....	5
Organizimi dhe Struktura Organizative e Ndërmarrjes	6
Forma e organogramit do të duket si në vijimi	7
Korniza Ligjore	7
Fushëveprimtria e Ndërmarrjes	8
Objektivat e Ndërmarrjes Publike Lokale “DARDANA” Sh.A.....	8
Pasqyra e të Ardhurave e Planifikuar TM 2025.....	10
Rritja e të hyrave dhe përmirësimi i gjendjes financiare.....	11
Analiza Swot.....	12
Problematika e përgjithshme dhe sfidat në menaxhimin e hapësirave publike.....	13
Metodologjia për përgatitjen e Planit për Menaxhimin e Hapësirave Publike.....	14
Trajtimi I Hapësirave Publike në Komunën e Kamenicës.....	15
Planifikimi Operativ dhe Financiar për Menaxhimin e Hapësirave Publike.....	15
Planifikimi i Burimeve Njerëzore për Ndërmarrjen Publike Lokale “DARDANA” SH.A.....	17
Planifikimi Financiar për vitin 2025.....	19
Ndryshimet në ekuitet 31.12.2025.....	19
Përshkrimi i investimeve kapitale për vitin 2025.....	20
Përmbledhja e shpenzimeve Investive	21
Qëndrueshmëria e Ndërmarrjes Publike Lokale “DARDANA”SH.A.....	22

Përmbledhje – Hyrje

Ndërmarrja Publike Lokale DARDANA Sh.A. Kamenicë është një ndërmarrje e regjistruar në Qendrën e Regjistrimit të Bizneseve (ARBK) më 28 mars 2024, e cila ka si qëllim ofrimin e shërbimeve dhe realizimin e projekteve të rëndësishme për zhvillimin lokal dhe mirëqenien e komunitetit. Aktivitetet e ndërmarrjes janë të ndryshme dhe përfshijnë sektorë të shumtë, si: mirëmbajtja e rrugëve lokale, trotuarëve, parqeve, shesheve dhe varrezave, si dhe shërbimet publike si ndriçimi dhe sinjalizimi.

Në përputhje me statutet dhe ndryshimet e miratuara së fundmi, DARDANA Sh.A. angazhohet në realizimin e aktiviteteve të tilla.

Gjatë vitit të parë të aktivitetit (2024), për shkak të përvojës dhe mungesës së pajisjeve të nevojshme, ndërmarrja nuk ka mundur të fillojë të gjitha veprimtaritë e planifikuara, por zgjerimi i veprimtarive do të ndodhë hap pas hapi në vitin e dytë dhe të tretë. Në vitin e parë, shërbimi më i vlerësuar nga qytetarët ka qenë pastrimi i ambienteve, një shërbim që është konsideruar i domosdoshëm për Komunën dhe ka pasur mbështetje të gjerë nga qytetarët.

Plani i biznesit është një dokument thelbësor për menaxhimin e ndërmarrjes. Ky plan është përgatitur nga Kryeshefi Ekzekutiv duke u bazuar në të dhënat e gjysmës së dytë të vitit 2024, trendet zhvillimore dhe kërkesat e sektorëve përkatës, duke ofruar një planifikim të detajuar për vitin 2025.

Në këtë plan, përshkruhen aktivitetet vjetore të ndërmarrjes, bazuar në strategjinë e saj, me qëllim ofrimin e informacionit të nevojshëm për vendimmarrje. Plani është i strukturuar në mënyrë të detajuar për secilin aspekt të afarizmit dhe do të monitorohet dhe rishikohet rregullisht nga Bordi i Drejtorëve, duke pasur parasysh ndodhi të pa parashikuara, si lidhja e kontratave, donacione të mundshme ose projekte të reja, si dhe rreziqe të fuqisë madhore. Rëndësia e këtij plani është se ai do të shërbejë si një udhëzues për Bordin e Drejtorëve dhe Kryeshefin Ekzekutiv së bashku me menaxhmentin e NPL "DARDANA" Sh.A., duke ndihmuar në zhvillimin dhe vendosjen e prioritetëve të investimeve në të ardhmen. Plani do të monitorohet gjatë gjithë vitit dhe mund të rishikohet nëse ka nevojë. Ai do të shërbejë gjithashtu si bazë për zhvillimin e ndërmarrjes dhe për përcaktimin e prioritetëve për të ardhmen, duke ofruar informacion të detajuar për menaxhmentin, Bordin e Drejtorëve dhe Komisionin Komunal të Aksionarëve.

Ky dokument do të sigurojë një orientim të qartë për vitin 2025 dhe do të shërbejë si bazë për planifikimin e aktiviteteve për vitet në vijim.

Misioni

Misioni i Ndërmarrjes Publike Lokale "DARDANA" Sh.A. është përmirësimi i shërbimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, rritja e pjesëmarrjes në treg, përmirësimi i pozicionit tekniko-financiar dhe qëndrueshmëria afatgjatë.

financiare. Synimi është ofrimi i shërbimeve cilësore për Komunën, operatorët ekonomikë publikë, si dhe për personat juridikë dhe fizikë.

Një tjetër aspekt i misionit të NPL "DARDANA" Sh.A. është t'i ofrojë shërbime të gjithë qytetarëve të Komunës së Kamenicës, pa dallim race, religjioni apo kombësie. Ndërmarrja angazhohet për të kontribuar në mirëqenien e qytetarëve dhe komunitetit, përfshirë organizimin e fushatave për ruajtjen e mjedisit, përmirësimin e infrastrukturës publike dhe promovimin e agjendës të gjelbër (Green Agenda).

Një tjetër mision i rëndësishëm për NPL "DARDANA" është mirëmbajtja e parqeve dhe hapësirave të gjelbra në qytet dhe, në një të ardhme, edhe në fshatra. Kjo ka për qëllim të sigurojë një mjedis të pastër dhe tërheqës për qytetarët, duke krijuar një ambient të qetë dhe të relaksuar për përdoruesit.

Në aspektin financiar dhe operativ, NPL "DARDANA" synon të jetë e vetë-qëndrueshme dhe afatgjatë, duke menaxhuar hapësirat dhe parkingjet publike sipas standardeve ndërkombëtare. Kjo do të sigurojë qëndrueshmërinë dhe rritjen e ndërmarrjes për të realizuar misionet e saj në të ardhmen.

Për të ardhmen e afërt, NPL "DARDANA" ka planifikuar zgjerimin e aktiviteteve, duke përfshirë menaxhimin e tregut të qytetit, kiosqeve, garazheve, mirëmbajtjen e banesave dhe ndriçimin e qytetit. Kjo do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe funksionimin efikas të infrastrukturës urbane.

Qasja e ndërmarrjes në afarizëm do të bazohet në transparencë dhe llogaridhënie, në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara. Transparenca dhe llogaridhënia do të realizohen në bashkëpunim me palët e interesit:

1. Qytetarët,
2. Bordi i Drejtorëve
3. Komisioni Komunal i Aksionarëve të NPL "DARDANA" Sh.A.,

Vizioni

Vizioni i Ndërmarrjes Publike Lokale "DARDANA" Sh.A. është të kontribon në krijimin e një qyteti të qëndrueshëm, të pastër dhe të zhvilluar për të gjithë qytetarët. Ky vizion përfshin zhvillimin e infrastrukturës, mbrojtjen e mjedisit, promovimin e mirëqenies dhe ruajtjen e hapësirave të gjelbra publike, duke krijuar gjithashtu mundësi të reja për hapësira të gjelbra në qytet.

Një qëllim kyç i vizionit është zgjerimi i shërbimeve të ofruara, duke siguruar një nivel të lartë cilësie të shërbimeve në përputhje me normat dhe standardet e Bashkimit Evropian. Po ashtu, ndërmarrja synon ruajtjen dhe mirëmbajtjen e aseteve të saj, rritjen e investimeve kapitale dhe garantimin e ofrimit të shërbimeve cilësore për klientët ekzistues dhe ata potencial.

Një tjetër dimension i vizionit të NPL "DARDANA" është ngritja e cilësisë së të gjitha shërbimeve, duke kontribuar në rritjen e besimit dhe reputacionit të ndërmarrjes. Kjo do të ndihmojë në drejtimin e ndërmarrjes drejt pozicionit të liderit në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Përmes aktiviteteve operative dhe financiare, ndërmarrja do të krijojë kushte të favorshme për rritjen e investimeve nga burimet vetanake dhe investitorët e tjerë. Përafrimi i realizimit të këtij vizioni do të krijojë mundësi për bashkëfinancim dhe investime të mëtijshme nga institucionet financiare.

PLANI I MARKETINGUT

Suksesi i një ndërmarrje sot në konkurrencën e tregut është i lidhur drejtpërdrejt me nivelin e organizimit të marketingut në kompani. Ne do të përdorim një shumëllojshmëri metodash marketingu, duke përfshirë përdorimin e rrjeteve sociale si një mjet kryesor për arritjen e publikut. Gjithashtu, do të investojmë kohë dhe energji për të rritur vetëdijësimin e qytetarëve, për t'i bërë ata më bashkëpunues me NPL.

Një nga iniciativat kryesore që do të ndërmarrim është koordinimi i aktiviteteve me sektorin e Ambientit dhe këshillat lokale për organizimin e fushatave vetëdijësuese për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit nëpër të gjitha lokalitetet e komunës. Do të organizojmë ligjërata nëpër shkolla dhe do të shpërndajmë fletëpalosje për ndarjen e mbeturinave dhe ruajtjen e ambientit. Kjo do të ndikojë pozitivisht edhe në zgjerimin e rrjetit për mbeturina në të gjitha lokalitetet e Komunës. Bashkëpunimi do të jetë gjithashtu me OJQ, radiot lokale, mjetet elektronike dhe ato të shkruara.

Për të arritur objektivat e përcaktuara për vitin 2025 dhe më tutje, do të kombinojmë disa fusha veprimtarish shërbyese në mënyrë që rezultatet të jenë më të mira dhe më të matshme. Kjo do të na mundësojë rritjen e pritjes ekonomike, si në shërbimet e mirëmbajtjes, pastrimin dhe ruajtjen e hapësirave publike gjelbëruese, etj. Ne do të zgjedhim strategjitë adekuate të marketingut për llojet e ndryshme të shërbimeve dhe për nevojat e ndryshme që ato kanë.

Në shërbimet tona, do të përdorim tri metoda strategjike:

1. **Metoda zgjeruese**, ku do të orientohejmë drejt klientëve ekzistues;
2. **Metoda depertuese/zgjeruese**, për të arritur klientët potencialë;
3. **Metoda të avancuara**, për të tërhequr klientët e rinj.

Për shërbimet që ofrojmë, do të përdorim **metodën zgjeruese**, ku do të orientohejmë drejt klientëve ekzistues dhe metodën **depertuese**, për të arritur klientët potencialë. Për shërbimin e mirëmbajtjes së rrugëve dhe hapësirave gjelbëruese, do të përdorim **metodën depertuese**, që do të orientohej në zbrazëtirat e identifikuara në treg.

Organizimi dhe Struktura Organizative e Ndërmarrjes

Sipas nenit 16 dhe nenit 21 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Statutit të N.P.L. "DARDANA" Sh.A. Kamenicë, Ndërmarrja menaxhohet nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe mbikqyret nga Bordi i Drejtorëve, i cili zgjidhet nga Komisioni Komunal i Aksionerëve.


